



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 23177/1 Prot.
Datë 28.12.21

AGJENCIA E PROKURIMIT
PUBLIK

Nr. 787 Prot.
Datë 23.12.21

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Autoriteteve/Enteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kanë finalizuar procesin e integrimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik (në vijim "SPE") me Sistemin e Menaxhimit Financiar (në vijim "AFMIS") lidhur me kontrollin e fondeve të vlefshme në thesar, gjatë krijimit të procedurës së prokurimit.

Bashkëlidhur, do të gjeni listën e të gjithë institucioneve buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në Web Portal dhe Sistemin Informatik Financiar Qeveritar që do të integrohen me SPE.

Sjellim në vëmendje se procesi i integrimit do të realizohet për të gjithë procedurat e prokurimit që zhvillohen në formë elektronike me përjashtim të procedurave **blerje me vlerë të vogël dhe sistem dinamik i biletave të transportit ajror ndërkombëtar, si dhe procedurat e prokurimit marrëveshje kuadër.**

Me datë **05.01.2022** do të fillojë procesi i integrimit të SPE me AFMIS për institucionet si më poshtë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit,

Nga data **01.02.2022** do të vijojë procesi i integrimit të SPE me AFMIS dhe për të gjithë autoritetet kontraktore, sipas listës bashkëlidhur.

Gjithashtu, në linkun <http://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udhezime/> është publikuar manuali teknik për t'ju ardhur në ndihmë autoriteteve/enteve kontraktore me hapat që duhet të ndjekin për krijimin e procedurave të prokurimit, duke bërë paraprakisht verifikime me Sistemin e Menaxhimit Financiar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

MINISTËR I FINANCËVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

